VENDIM
Nr. 35, datë 27.1.2021

PËR PLANIN VJETOR TË PRANIMIT, PËR VITIN 2021, NË INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS SHTETËRORE, PJESË TË SHËRBIMIT CIVIL

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i vendeve vakante të planifikuara për rekrutim gjatë vitit 2021 është, gjithsej, 705 (shtatëqind e pesë), të ndara sipas kategorive të mëposhtme:

a) për trupën e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues 4;
b) për kategorinë e mesme drejtuese 60;
c) për kategorinë e ulët drejtuese 169;
ç) për kategorinë ekzekutive 472.

2. Grupet e administrimit të përgjithshëm dhe të posaçëm në kategorinë ekzekutive janë, si më poshtë vijon:

- Shkenca juridike;
- Audit i brendshëm;
- Shkenca ekonomike;
- Shkenca ekonomike/juridike;
- Shkenca shoqërore;
- Shkenca sociale;
- Histori-filologji;
- Shkenca mjekësore;
- Veterinari;
- Agronomi;
- Shkenca biologjike dhe të ngjashme me to;
- Kimi;
- Shkenca mjedisore ose të tjera të përshtatshme;
- Shkenca inxhinierike;
- Arkitekturë;
- Arkeologji dhe restaurime;
- Arte të bukura;
- Gjeodezi;
- Shkenca ekzakte;
- Shkenca edukimi;
- Mësuesi;
- Arsim i lartë ushtarak/policor;
- Arsim i lartë.

3. Institucionet e administratës shtetërore, ku planifikohen vendet vakante gjatë vitit 2021, janë sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Ngarkohet Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lidhja nr. 1

LISTA E INSTITUCIONEVE TË ADMINISTRATËS SHTETËRORE KU PLANIFIKOHEN VENDET VAKANTE GJATË VITIT 2021

1. Kryeministria dhe institucionet e saj të varësisë;
2. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme;
3. Sistemi i Ministrisë së Brendshme;
4. Ministria e Mbrojtjes;
5. Sistemi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë;
6. Sistemi i Ministrisë së Drejtësisë;
7. Sistemi i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;
8. Sistemi i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
9. Sistemi i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit;
10. Sistemi i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
11. Sistemi i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
12. Ministria e Kulturës.